



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:183388
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05575611

Ac.nr.1805/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit L.K. nga Suhareka, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.N., avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G.D., për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, C.nr.373/14, datë 20.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

IREFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, C.nr.373/14, i datës 20.01.2020, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.373/14, të datës 20.01.2020, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit L.K. nga Suhareka. Në pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura KS “S...”, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 10,887.50 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data e marrjes - pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën

definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,156.30 të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën III të dispozitivit detyrohet e paditura që shumën e gjykuar në emër të dëmit material, kamatën dhe shpenzimet e procedurës t'ia paguaj paditësit në afatin prej 15 ditëve nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 18.12.2014, në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurës ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.373/2014 të datës 20.01.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë përderisa e autorizuar e të paditurës palës paditëse i ka afuar ofertë për arritjen e marrëveshjes. Në këtë rast kontestuese ishte pjesërisht lartësia e kërkesëpadisë. Gjykata ka vendosur për lartësinë e kërkesëpadisë nga ekspertiza e makinerisë e punuar nga Ing. S.SH, eksperti i makinerisë i cili në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc, në shqyrtimin shkresat e lëndës C.nr. 373/14, në cilësinë e ekspertit e ka bërë vlerësimin e dëmit material për automjetin e udhëtarëve të tipit "...” me targa të regjistrimit të shkaktuar në aksident trafiku. Eksperti duke dhënë mendimin lidhur me dëmin e shkaktuar në automjetin i cili është objekt kontesti ka konstatuar se dëmi në automjetin ".....” është llogaritur si dëm total teknik, automjeti teknikisht është i riparueshëm. Çmimi i automjetit është llogaritur në bazë të çmimit të tregut të brendshëm dhe të jashtëm, duke llogaritur këtu edhe taksat doganore dhe transportin nga jashtë, është llogaritur çmimi i automjetit sipas shkallës së shfrytëzimit në bazë të literaturës është llogaritur në aspektin teknik vlera e mbetur e automjetit prej nga rezulton se vlera e automjetit në kohën e aksidentit ka qenë 16,750.00 €, vlera e pjesës së mbetur e automjetit është llogaritur në masën 35.5 % duke ardhur në përfundim se vlera e dëmit në automjetin "...”, në kohën e aksidentit ka qenë Vlera e dëmit 16,750.00 - 35% ë 10,887.50€ (dhjetë mijetë e qindë të dhjetës euro e pesë dhjetë cent). Gjykata ekspertizës ia fali besimin e plotë ngase ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhënave mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyet e mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin material të shkaktuar paditësit me rastin e aksidentit të trafikut për çka e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensoj dëmin meqë shkaktues i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurës Kompania e Sigurimit "Siguria" me seli në Prishtinë, dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bënë e paditura mbi bazën e sigurimit të

auto përgjegjesisë konform nenit 159 dhe 136 të LMD-së. Duke u bazuar në dispozitat e caktuar më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve në automjetin e tipit “....” në bazë të ekspertizës së makinerisë të përshkruar më lartë, gjykata e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit në vlerën e shpërblimit të dëmit material si nën pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, duke e vlerësuar si shpërblim real dhe objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e dëmit material të shkaktuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 136 dhe 159 të LMD-së. Për kamatën gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382 paragraf 2 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë...., rreth orës ... minuta, në rrugën magjistrale.... përkatësisht në fshatin...., Komuna e Drenasit. Shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit “.....”, me targa të regjistrimit i siguruar te e paditura, gjersa paditësi nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti. Të gjitha këto rrethana janë vërtetuar me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, ku lartësia e dëmit material në automjetin e dëmtuar të paditësit është vërtetuar në bazë të ekspertizës nga lëmia e makinerisë e datës 25.11.2019 e punuar nga eksperti S.SH. Në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike ndërsa në këtë rast, me qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, e paditura me njoftimin e datës 22.10.2014 i ka ofruar ofertë në lartësi prej 4.230 €, të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjene mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 përcaktohet se “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me

nenin 159 përcaktohet se “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Gjykata e Apelit si të drejtë e vlerëson edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me lartësinë e kamatës së gjykuar, pasi lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 20.01.2020, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij është vënë në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1805/2020, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli